VENDIM
Nr. 21, datë 26.9.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:
Vitore Tusha kryetare;
Marsida Xhaferllari anëtare;
Fiona Papajorgji anëtare;
Elsa Toska anëtare;
Sonila Bejtja anëtare;
Sandër Beci anëtar;
Altin Binaj anëtar,

me sekretare Enina Kotoni, në datën 20.9.2022 mori në shqyrtim në seancë plenare publike, çështjen nr. 1 (L) 2022 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: LUAN DACI, përfaqësuar nga avokat Jordan Daci

SUBJEKT I INTERESUAR:

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në mungesë

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 32, datë 1.12.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 5, datë 8.3.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2021-670 (63), datë 26.10.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 5, 17, 29, 33, 42, 43, 122, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 6, 7, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)* dhe neni 2 i Protokollit Shtesë nr. 7; neni 14 i Paktit Ndërkombëtar të të Drejtave Civile dhe Politike; nenet 22, 27, 49, 50, 70, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Altin Binaj, shqyrtoi pretendimet e paraqitura nga kërkuesi Luan Daci, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, parashtrimet e paraqitura me shkrim nga subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme),* që kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë *(Kuvendi)*, me vendimin nr. 82/2017, datë 17.6.2017, ka zgjedhur kërkuesin Luan Daci *(kërkuesi)* gjyqtar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit *(KPA)*. Zgjedhja e tij në përbërje të këtij institucioni kushtetues ka ardhur në përmbyllje të një procesi të administruar nga Institucioni i Avokatit të Popullit *(Avokati i Popullit)* dhe Kuvendi. Konkretisht, kërkuesi në datën 3.2.2017 i ka paraqitur Avokatit të Popullit kërkesën për aplikim dhe emërim në

vendet vakante, të shpallura në bazë të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" *(ligji nr. 84/2016)*.

2. Ndërkohë, nga kallëzimi i paraqitur në Prokurorinë e Posaçme dhe materialet bashkëlidhur, ka rezultuar se kërkuesi deri në vitin 1997 ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr. 6, datë 24.12.1997, pas propozimit të ministrit të Drejtësisë, ka vendosur: *"Z. Luan Daci, largohet nga detyra e gjyqtarit për shkelje të ligjës dhe paaftësi në detyrë",* rrethanë të cilën kërkuesi nuk e kishte pasqyruar në kërkesën për aplikim.

3. Mbi këto fakte, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal nr. 56 të vitit 2020 për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve", të parashikuar nga neni 186, paragrafi i parë, i Kodit Penal *(KP)*.

4. Gjatë fazës së hetimeve paraprake, Prokuroria e Posaçme i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar *(Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë)* për caktimin e masës ndaluese "Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik". Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 54, datë 20.5.2020, ka vendosur pranimin e kërkesës me arsyetimin se niveli i provave të administruara deri në këtë fazë krijonte dyshimin se kërkuesi ishte autor i veprës penale.

5. Ndaj vendimit ka ushtruar ankim kërkuesi dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar *(Gjykata e Posaçme e Apelit)*, me vendimin nr. 15, datë 5.6.2020, ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 54, datë 20.5.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë. Në vendim Gjykata ka arsyetuar, se: *"duke qenë përpara mungesës së kundërligjshmërisë së faktit, pra përpara një fakti jo penal, nuk përmbushet kushti, në radhë i pari, i caktimit të kujtdo mase sigurimi personal, që është ai i dyshimit të arsyeshëm, sepse ky dyshim i arsyeshëm duhet të bjerë mbi faktin penal dhe jo mbi atë jo penal. Rrjedhimisht, sepse me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë është caktuar një masë ndaluese, në situatën e mungesës së kushtit të "dyshimit të arsyeshëm" kur në këtë situatë ligji e ndalon caktimin e saj, ky kolegj vlerëson se ajo duhet të shfuqizohet" (shih faqen 4 të vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit)*.

6. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar rekurs Prokuroria e Posaçme. Çështja me objekt caktimin e masës ndaluese "Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik" është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 24.6.2020. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e ndërmjetëm të datës 18.9.2020, ka vendosur kalimin për gjykim të çështjes penale.

7. Ndërkohë me vendimin e prokurorëve të datës 15.7.2020, kërkuesit i është komunikuar akuza, duke u marrë në cilësinë e të pandehurit për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve", të parashikuar nga neni 186, paragrafi i parë, i KP-së. Në vijim, çështja është dërguar për gjykim.

8. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 32, datë 1.12.2020, ka vendosur: *"Deklarimin fajtor të të pandehurit Luan Daci, për kryerjen e veprës penale të "Falsifikimit të dokumenteve", të parashikuar nga neni 186/1 i KP dhe dënimin e tij me 6 (gjashtë) muaj burgim. Në bazë të nenit 63 të K. Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim me kusht që i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale brenda një afati prove prej 12 muajsh."*.

9. Ndaj vendimit të mësipërm ka ushtruar ankim kërkuesi, si dhe apel kundërshtues Prokuroria e Posaçme. Gjykata e Posaçme e Apelit, me vendimin nr. 5, datë 8.3.2021, ka vendosur: *"Lënien në fuqi të vendimit nr. 32 datë 1.12.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar"*.

10. Ndaj këtij vendimi në datën 20.4.2021 kërkuesi ka ushtruar rekurs. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, duke marrë parasysh edhe dy kërkesat për përshpejtimin e shqyrtimit të rekursit të paraqitura nga kërkuesi dhe nga KPA-ja, me vendimin nr. 00-2021-670 (63), datë 26.10.2021, ka vendosur: *"Mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi Luan Daci kundër vendimit nr. 5, datë 8.3.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar",* me arsyetimin se nuk përmbante asnjë shkak ligjor të kërkuar nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale *(KPP)*. Pas përfundimit të çështjes së themelit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, për rekursin e paraqitur nga Prokuroria e Posaçme për caktimin e masës ndaluese, me vendimin nr.

00-2022-116 (55), datë 18.2.2022, ka vendosur mospranimin e tij, pasi Prokuroria e Posaçme kishte paraqitur kërkesë për heqje dorë nga rekursi.

11. Kërkuesi në datën 17.1.2022 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual sipas objektit të sipërcituar. Kolegji i Gjykatës në datën 11.3.2022 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 30.3.2022 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. Kërkuesi ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se vendimet gjyqësore të kundërshtuara kanë cenuar:

12.1 *Të drejtën për proces të rregullt ligjor* në aspektet e mëposhtme:

12.1.1 *Parimi i paanshmërisë dhe pavarësisë,* pasi çështja e themelit në Gjykatën e Lartë është gjykuar nga i njëjti gjyqtar relator sikurse edhe çështja për caktimin e masës së sigurimit "Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik". Për këtë të fundit, i njëjti trup gjykues i Gjykatës së Lartë ka vendosur kalimin për gjykim të çështjes penale, ndërsa çështja e themelit (vendimet e së cilës janë objekt i ankimit kushtetues) është shqyrtuar në dhomë këshillimi. Ky qëndrim nuk është në përputhje me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, pasi janë përdorur standarde të ndryshme për shqyrtimin e rekursit.

12.1.2 *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat kanë arsyetuar në mënyrë kontradiktore e jo të ligjshme. Ato kanë bërë një interpretim të zgjeruar, duke krijuar një normë të re, krijimi i së cilës është atribut i ligjvënësit. Kërkesa ka si qëllim vënien në lëvizje të organit procedues dhe nuk cenon interesin publik që në këto organe të zgjidhen persona që plotësojnë kriteret. Gjykata gabon në arsyetim duke i atribuuar kërkesës vlerën e shkresës private dhe i ngatërron me qëllim elementet e domosdoshme të përmbajtjes së një akti sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative*,* si dhe elementet e figurës së veprës penale të falsifikimit të dokumenteve. Gjykata e Lartë abuzon kur shprehet se Gjykata e Posaçme e Apelit ka dhënë përgjigje për secilin pretendim, pasi në fakt ajo gjykatë ka arsyetuar njëlloj si Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë. Gjykatat, duke përfshirë edhe Gjykatën e Lartë, në vendimet e tyre injorojnë faktin që edhe sipas doktrinës së huaj, së cilës ato i referohen, falsifikimi ideologjik bëhet nga nëpunësi publik dhe jo nga një person privat.

12.1.3 *E drejta për të mos u dënuar pa ligj,* e parashikuar në nenin 29 të Kushtetutës, pasi vepra penale për të cilën është deklaruar fajtor kërkuesi nuk parashikohet në ligj dhe nuk ekziston si fakt juridik. Akuza dhe vendimet e gjykatave, në thelb, kanë dhënë një dënim pa ligj, pasi KP-ja nuk parashikon veprën penale të falsifikimit ideologjik dhe "falsifikimi intelektual" është një shprehje pa asnjë kuptim gjuhësor dhe ligjor, madje nuk e njeh as jurisprudenca shqiptare. Gjykatat kanë interpretuar gabim nenin 186 të KP-së lidhur me ekzistencën ose jo të veprës penale për të cilën është dënuar kërkuesi. Ato kanë bërë një vlerësim të gjerë dhe praktikisht kanë kriminalizuar çdo lloj shkrese që mund të përmbajë të dhëna "false" pa marrë parasysh juridikisht natyrën, qëllimin, funksionin dhe efektin e dokumentit.

12.1.4 *E drejta për t'u dëgjuar para se të gjykohet*, pasi çështja në Gjykatën e Lartë është shqyrtuar në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve. Për shkak të problematikës dhe kompleksitetit të çështjes, duke respektuar parimin e barazisë para ligjit, ekzistonte një interes i lartë publik që çështja e kërkuesit të merrte një trajtim të gjithanshëm dhe shterues nëpërmjet shqyrtimit në seancë gjyqësore për të dëgjuar palët. Gjithashtu, ka kontradikta mes vendimit objekt ankimi kushtetues dhe vendimit nr. 15, datë 5.6.2020, të Gjykatës së Posaçme të Apelit (me objekt caktimin e masës së sigurimit).

12.1.5 *E drejta për ankim efektiv sipas nenit 43 të Kushtetutës,* e cila nënkupton ekzistencën e mjeteve të ankimit efektiv, por në rastin konkret ankimi në Gjykatën e Apelit dhe rekursi në Gjykatën e Lartë nuk kanë rezultuar të jenë mjete ankimi efektive.

12.1.6 *E drejta për zgjidhjen efektive dhe e apelit në çështjet penale*, të parashikuara në nenin 13 të KEDNJ-së dhe në nenin 2 të Protokollit Shtesë nr. 7 të saj, pasi çdo ankim pas zbatimit të dënimeve nuk do të bënte të mundur një "*restitutio integrum"* të të drejtave dhe interesave të ligjshme të subjekteve që do të mund të cenoheshin.

12.2 *Nenin 17 të Kushtetutës dhe parimin e proporcionalitetit*, pasi qëndrimi i gjykatave se neni 33 i ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" *(ligji nr. 9877/2008)* parashikon se masa e shkarkimit nga detyra nuk shuhet asnjëherë, është ndalim krejtësisht jo logjik dhe që bie ndesh me të kuptuarit e normave juridike si pjesë e një rendi juridik. Nëse kjo normë do të nënkuptohej si ndalim i përgjithshëm dhe i përhershëm i lidhur me një masë disiplinore, do të ishte një normë antikushtetuese, sepse bie ndesh me parimin e proporcionalitetit.

12.3 *Parimin e mosdiskriminimit,* pasi kërkuesi diskriminohet në raport me persona të tjerë, subjekt të masave të sigurisë, të cilët kanë të drejtën e ankimit ndaj vendimit për refuzimin ose pranimin e kërkesës për shuarje. Një shkelje disiplinore nuk mund të sjellë pasoja të përhershme juridike ndaj një personi, ndërkohë që një gjë të tillë nuk e bën as dënimi penal për krimet më të rënda. Gjykatat kanë arsyetuar për shuarjen ose jo të masës disiplinore në mënyrë të paqartë dhe paragjykuese. Shuarja e masës disiplinore parashikohet edhe në rastin më ekstrem, sikurse është dekriminalizimi.

12.4 *Dinjitetin,* pasi është dëmtuar rëndë reputacioni dhe interesat financiare, si dhe disa parime, ai i ligjshmërisë, shtetit të së drejtës, hierarkisë së normave juridike, ndarjes së pushteteve dhe i së drejtës ndërkombëtare të detyrueshme.

13. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka paraqitur parashtrime me shkrim, duke prapësuar se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara. Në mënyrë të përmbledhur argumentet janë si më poshtë:

13.1 *Në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor,* gjykatat kanë trajtuar në mënyrë shteruese të gjitha pretendimet, për rrjedhojë pretendimi është i pabazuar. Mospajtimi me arsyetimin e gjykatave, që kanë shqyrtuar çështjen penale në ngarkim të kërkuesit për çështje që kanë të bëjnë me interpretimin e ligjit penal, në veçanti të nenit 186 të KP-së, nuk përbën shkak në vetvete që këto pretendime të ngrihen në nivel të juridiksionit kushtetues.

13.2 *Për pretendimin e dënimit pa ligj,* kërkuesi nuk është dënuar për ndonjë vepër penale të paparashikuar në ligj, por për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve", të parashikuar në nenin 186, paragrafi i parë, të KP-së. Gjatë proceseve gjyqësore, pretendimi se fakti nuk përbën vepër penale dhe se fakti penal nuk ekziston është vlerësuar nga të tria gjykatat, të cilat kanë arsyetuar se fakti penal ekziston dhe se ai është kryer nga kërkuesi.

13.3 Pretendimi i kërkuesit se masa disiplinore "largim nga detyra" është shuar, është i pabazuar, pasi pika 1 e nenit 6 të ligjit nr. 84/2016 nuk e lidh ekzistencën e saj me ndonjë afat kohor. Ligji në momentin e aplikimit është ligji nr. 96/2016, i cili në nenin 150, pika 3, parashikon, se: *"masa disiplinore e shkarkimit nga detyra nuk shuhet dhe nuk fshihet nga regjistri"*.

13.4 Pretendimet e parashtruara në Gjykatën Kushtetuese nuk kanë të bëjnë me shkeljen e një dispozite kushtetuese, të ndonjë parimi ose të drejte kushtetuese ose procedurale. Pretendimet, në thelb, lidhen me mënyrën e zbatimit dhe interpretimin e ligjit material penal, me interpretimin e nocioneve "dokument" dhe "falsifikim", si dhe me vlerësimin e provave të paraqitura e të shqyrtuara në gjykim, për rrjedhojë ato nuk janë pjesë e juridiksionit kushtetues, por përfshihen në juridiksionin e gjykatave të zakonshme.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për kërkesën për të thirrur si subjekt të interesuar Avokatin e Popullit

14. Kërkuesi në parashtrimet e depozituara në datën 22.4.2022, si dhe në seancën plenare publike ka kërkuar thirrjen e Avokatit të Popullit si subjekt të interesuar, në ndihmë të gjykimit kushtetues, pasi është institucioni që ka kryer të gjitha procedurat dhe ka administruar dokumentacionin që është bërë shkak për procedimin penal ndaj kërkuesit.

15. Gjykata vëren se në nenin 39, shkronjat "b", "c" dhe "ç", të ligjit nr. 8577/2000 janë përcaktuar subjektet që marrin pjesë në gjykimin kushtetues. Në lidhje me subjektet e interesuara që thirren në çështje me interes publik, Gjykata është shprehur se në vlerësimin e legjitimimit të subjektit të interesuar bazohet jo vetëm në interes të subjektit, por dhe të gjykimit kushtetues. Në këtë vështrim, në gjykimet kushtetuese legjitimohen si subjekte të interesuara ato subjekte që, për shkak të veprimtarisë ose rrethanave, mund të kontribuojnë në shqyrtimin e çështjes që po gjykohet, pavarësisht nëse thirren në gjykim me kërkesën e kërkuesit apo dhe kryesisht nga Gjykata *(shih vendimet nr. 18, datë 7.7.2022; nr. 9, datë 1.3.2021; nr. 9, datë 23.3.2010; nr. 29, datë 21.10.2009, të Gjykatës Kushtetuese).*

16. Për sa më lart, Gjykata mori në shqyrtim kërkesën për të thirrur Avokatin e Popullit, si subjekt të interesuar, dhe vlerësoi se nuk ekziston nevoja e pjesëmarrjes të tij në interes të këtij gjykimi kushtetues.

B. Për legjitimimin e kërkuesit

17. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Individi, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i" dhe 134, pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

18. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

19. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, pra duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

20. Gjykata vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi është palë në procesin gjyqësor penal, për të cilin ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

21. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në rastin konkret kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimeve sipas objektit, pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit, duke paraqitur përpara tyre, në substancë, pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues. Për rrjedhojë, kërkuesi i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

22. Për sa i përket legjitimimit *ratione temporis*, Gjykata vëren se shkronja "b" e pikës 1 të nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000 parashikon se afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi ka përfunduar me vendimin nr. 00-2021-670 (63), datë 26.10.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, kurse ankimi kushtetues individual është depozituar në Gjykatë në datën 17.1.2022, pra brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga ligji.

23. Për legjitimimin *ratione materiae* kërkuesi ka parashtruar se gjatë gjykimit është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, për rrjedhojë Gjykata vlerëson se pretendimet janë në juridiksionin e saj dhe në vijim do të shqyrtojë bazueshmërinë e tyre.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1. Për pretendimin e cenimit të parimit të paanshmërisë

24. Kërkuesi ka parashtruar se gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë është cenuar parimi i paanshmërisë, pasi çështja objekt shqyrtimi është gjykuar nga i njëjti gjyqtar sikurse edhe çështja me objekt kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për caktimin e masës ndaluese. I njëjti trup gjykues i Gjykatës së Lartë për çështjen me objekt caktimin e masës ndaluese ka vendosur kalimin për shqyrtim në seancë gjyqësore, ndërsa për çështjen e themelit ka vendosur shqyrtimin në dhomën e këshillimit. Ky qëndrim nuk është në përputhje me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, pasi janë përdorur standarde të ndryshme për pranimin e rekursit.

25. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, nuk ka parashtruar prapësime në lidhje me këtë pretendim.

26. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet *(shih vendimet nr. 10, datë 12.4.2022; nr. 49, datë 10.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese)*.

27. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin *objektiv,* me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit nga vetë ajo të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata merr parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohen nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Në shtetin e së drejtës kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por dhe çdo qytetar i thjeshtë *(shih vendimet nr. 15, datë 11.3.2021; nr. 6, datë 29.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese)*.

28. Jurisprudenca e Gjykatës ka evidentuar se parimi i paanshmërisë në gjykim, në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit, duke mos përjashtuar as shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit të Gjykatës së Lartë. Për Gjykatën është konsideruar gjykatë e njëanshme trupi gjykues në përbërje të të cilit ka qenë i pranishëm qoftë edhe vetëm një gjyqtar, i cili në këndvështrimin objektiv nuk jepte garanci për një gjykim të paanshëm. Gjykata ka theksuar, se: "thjesht dhe vetëm pjesëmarrja e një ose më shumë gjyqtarëve në një procedim të mëparshëm, pavarësisht nga ndikimi i prezencës dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjykues, është një arsye e mjaftueshme dhe njëkohësisht një garanci më pak për kërkuesin, tek i cili është krijuar dyshimi i bazuar se gjykata nuk ka qenë e paanshme në shqyrtimin e kësaj çështjeje" (*shih vendimin nr. 21, datë 29.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Ligji procedural penal përcakton rregulla të tilla që bëjnë dallim thelbësor mes fazës së hetimit paraprak dhe fazës së gjykimit. Në fazën e gjykimit, gjykata duhet të marrë vendime pa qenë e ndikuar nga vendimmarrja e mëparshme, qoftë edhe kur ato bazohen në dyshime të arsyeshme. Gjykata ka çmuar se paragjykimi eventual për paanësinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën kur gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt *(shih vendimet nr. 10, datë 12.4.2022; nr. 49, datë 10.7.2015; nr. 21, datë 29.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese)*.

30. Në funksion të këtij parimi të rëndësishëm kushtetues, konkretisht lidhur me papajtueshmërinë për shkak të pjesëmarrjes në procedim, në pikën 2 të nenit 15 të KPP-së

parashikohet se nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka shqyrtuar kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake ose në seancë paraprake për të njëjtin procedim, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Kod. Ky detyrim parashikohet edhe nga neni 17, pika 1, shkronja "e", i KPP-së, sipas të cilit gjyqtari duhet të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete kur ndodhet në një nga kushtet e papajtueshmërisë, të parashikuara nga neni 15 i KPP-së. Në këtë drejtim, edhe Gjykata është shprehur se ligji nuk përjashton që gjyqtari, i cili ka shqyrtuar një kërkesë gjatë hetimit paraprak, të shqyrtojë një kërkesë tjetër të të njëjtit lloj ose të një lloji tjetër në të njëjtin procedim, por parimi është që gjyqtari që ka vleftësuar çdo kërkesë të prokurorit gjatë hetimeve paraprake, ka papajtueshmëri me gjyqtarin që merr pjesë në gjykimin e çështjes (*shih vendimet nr. 18, datë 2.4.2012; nr. 40, datë 22.9.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Gjykata mban në konsideratë gjithashtu jo vetëm pozicionin dhe rolin kushtetues të Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji, për sa kohë ajo ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta *(shih vendimet nr. 20, datë 22.9.2022; nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 3, datë 6.2.2018, të Gjykatës Kushtetuese)*, por edhe funksionin që kryejnë kolegjet e saj në seleksionimin e rekurseve që nuk përmbajnë shkaqe të parashikuara nga ligji *(shih vendimet nr. 14, datë 21.6.2022; nr. 6, datë 16.2.2021; nr. 64, datë 16.10.2017, të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këtë drejtim, respektimi i parimit të paanshmërisë në Gjykatën e Lartë vlerësohet në këndvështrim të rrethanave të veçanta të çështjeve konkrete, të lidhura me procesin që zhvillohet në atë gjykatë, si dhe me natyrën dhe kompleksitetin e çështjes.

32. Në rastin konkret, pas regjistrimit të procedimit penal, Prokuroria e Posaçme i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për caktimin e masës ndaluese "Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik", e cila, me vendimin nr. 54, datë 20.5.2020, ka vendosur pranimin e kërkesës. Ndaj vendimit ka ushtruar ankim kërkuesi dhe Gjykata e Posaçme e Apelit, me vendimin nr. 15, datë 5.6.2020, ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 54, datë 20.5.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, pasi e ka vlerësuar faktin, për të cilin kërkohej caktimi i masës ndaluese, si jo penal. Mbi rekursin e ushtruar nga Prokuroria e Posaçme, çështja për caktimin e masës ndaluese është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 24.6.2020, ku është caktuar trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët S.S., E.P. dhe I.P. (relator). Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, në datën 18.9.2020 ka vendosur kalimin për gjykim të çështjes penale.

33. Ndërkohë kërkuesit i është komunikuar akuza duke u marrë në cilësinë e të pandehurit për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve". Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 32, datë 1.12.2020, ndër të tjera, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim. Pas ankimit të kërkuesit, Gjykata e Posaçme e Apelit, me vendimin nr. 5, datë 8.3.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë. Mbi rekursin e ushtruar nga kërkuesi çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 8.6.2021. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët I.P., A.V. dhe K.K. (relator), me vendimin nr. 00-2021-670 (63), datë 26.10.2021, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante asnjë shkak ligjor të parashikuar nga nenin 432 i KPP-së.

34. Gjykata çmon se në rastin konkret objekt i rekurseve të ushtruara, si në rastin e vleftësimit të masës ndaluese, ashtu edhe në shqyrtimin e çështjes për kryerjen e veprës penale, ka qenë vlerësimi i faktit, duke analizuar të njëjtat prova dhe rrethana të çështjes. Të dyja gjykimet, pavarësisht nga forma dhe referenca ligjore e paraqitjes së pretendimeve, lidhen me shqyrtimin dhe vlerësimin në tërësi të të njëjtit fakt, nëse përbën ose jo vepër penale.

35. Konkretisht, Gjykata vëren se gjyqtari I.P. ka qenë pjesë e trupit gjykues në dy kolegje penale të Gjykatës së Lartë. Në njërin kolegj, në datën 18.9.2020, ka vlerësuar shkaqet e rekursit të ushtruar nga Prokuroria e Posaçme dhe aktet e masës ndaluese duke vendosur kalimin për shqyrtim të çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Në kolegjin tjetër, në datën 26.10.2021, ka shqyrtuar çështjen në dhomë këshillimi dhe ka vlerësuar shkaqet e rekursit të

ushtruar nga kërkuesi, duke analizuar të njëjtat rrethana dhe të njëjtin fakt, të cilësuar si penal, duke vendosur mbi fajësinë e kërkuesit.

36. Gjykata vlerëson se në çështjen konkrete, për shkak të natyrës së veçantë të saj, kompleksitetit, pjesëmarrja e të njëjtit gjyqtar në dy vendime të dhëna nga kolegjet penale të Gjykatës së Lartë, duke vlerësuar aktet për të njëjtat rrethana dhe duke e dokumentuar këtë vlerësim, krijon dyshime në respektimin e kriterit objektiv të parimit të paanshmërisë. Ndërkohë, objektivisht ka ekzistuar mundësia për shmangien e pjesëmarrjes së të njëjtit gjyqtar në të dyja gjykimit, pasi, sikurse rezultoi, çështja gjyqësore penale për themelin është regjistruar rreth një vit pas regjistrimit të çështjes për caktimin e masës ndaluese dhe është shqyrtuar rreth katër muaj përpara çështjes për caktimin e masës së sigurimit.

37. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimi për cenimin e parimit të paanshmërisë gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë është i bazuar.

C.2. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me dënimin pa ligj

38. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat kanë arsyetuar në mënyrë kontradiktore e jo të ligjshme. Ato kanë bërë një interpretim të zgjeruar duke krijuar një normë të re, krijimi i së cilës është atribut i ligjvënësit. Gjykatat në thelb kanë dhënë një dënim pa ligj, pasi KP-ja nuk parashikon veprën penale të falsifikimit ideologjik dhe "falsifikimi intelektual" është një shprehje pa asnjë kuptim gjuhësor dhe ligjor, madje nuk e njeh as jurisprudenca shqiptare. Gjykatat kanë interpretuar gabim nenin 186 të KP-së lidhur me ekzistencën ose jo të veprës penale, për të cilën është dënuar kërkuesi.

39. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se gjykatat kanë trajtuar në mënyrë shteruese të gjitha pretendimet, për rrjedhojë pretendimi është i pabazuar. Mospajtimi me arsyetimin e gjykatave, që kanë shqyrtuar çështjen penale në ngarkim të kërkuesit për çështje që kanë të bëjnë me interpretimin e ligjit penal, në veçanti të nenit 186 të KP-së, nuk përbën shkak në vetvete që këto pretendime të ngrihen në nivel të juridiksionit kushtetues. Kërkuesi nuk është dënuar për ndonjë vepër penale të paparashikuar në ligj, por për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve", të parashikuar në nenin 186, paragrafi i parë, të KP-së.

40. E drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar vazhdimisht se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimin nr. 67, datë 10.11.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se ky detyrim ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, dhe se masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2021; nr. 79, datë 14.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Gjykata në këtë drejtim ka vlerësuar se është kompetencë e Kolegjit Civil/Penal (dhoma e këshillimit) të analizojë dhe çmojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Megjithatë, ky standard nuk duhet kuptuar sikur i mundëson Gjykatës së Lartë ushtrimin e kompetencës së mësipërme në mënyrë diskrecionale. Gjykata ka theksuar se standardet kushtetuese për një proces të rregullt ligjor duhen respektuar në të gjitha fazat e gjykimit, përfshirë këtu shqyrtimin e rekursit nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit *(shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2021; nr. 27, datë 27.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese).*

42. Gjykata thekson se në paragrafin e parë të nenin 29 të Kushtetutës parashikohet: *"Askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj, me përjashtim të veprave, të cilat në kohën e kryerjes së tyre, përbënin krime lufte ose krime*

kundër njerëzimit sipas së drejtës ndërkombëtare". Ndërsa në nenin 2 të KP-së parashikohet: *"askush nuk mund të dënohet penalisht për një vepër penale që më parë nuk është parashikuar shprehimisht në ligj si krim ose kundërvajtje penale. Askush nuk mund të dënohet me një lloj dhe masë dënimi të paparashikuar në ligj."*.

43. Gjykata rithekson se KP-ja përbën ligjin më të rëndësishëm, ku përmblidhen në mënyrë të sistemuar dispozitat penalo-juridike. Ky Kod përmban jo vetëm parimet kryesore mbi të cilat duhet të mbështetet drejtësia penale, por edhe veprat të cilat konsiderohen si të dënueshme. Një nga parimet kryesore që përshkon këtë Kod është edhe parimi i ligjshmërisë që nënkupton parashikimin me ligj të veprave penale dhe mosdënimin për një vepër që nuk është parashikuar shprehimisht si krim ose kundërvajtje penale. Qëllimi i këtij parimi është jo vetëm respektimi i ligjit për çdo rast dhe për çdo vepër penale, por edhe njohja e subjekteve me të gjitha ato veprime apo mosveprime, të cilat konsiderohen të dënueshme. Duke qenë se Kodi Penal, krahas Kushtetutës, është burimi kryesor i së drejtës penale dhe në zbatim të parimit të ligjshmërisë, parashikimi i veprave penale duhet të bëhet pikërisht në këtë Kod, si ligji bazë që parashikon krimet dhe kundërvajtjet penale ose në një ligj të barasvlershëm me të nga fuqia juridike. Një gjë e tillë i vjen në ndihmë shtetasve, të cilët mund të orientohen më mirë në kuadrin e gjerë të ligjeve që mund të parashikojnë vepra penale, me qëllim njohjen e tyre me ndalimet ligjore sipas fushave të ndryshme *(shiko vendimet nr. 50, datë 10.7.2015; nr. 3, datë 5.2.2010, të Gjykatës Kushtetuese)*.

44. Në çështjen konkrete, sikurse u parashtrua më sipër, rekursi i paraqitur nga Prokuroria e Posaçme për vendosjen e masës ndaluese është shqyrtuar në seancë gjyqësore, ndërsa rekursi i paraqitur nga kërkuesi ndaj vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për çështjen penale të themelit është shqyrtuar në dhomën e këshillimit. Gjykata konstaton se, nga përmbajtja e vendimit nr. 00-2021-670 (63), datë 26.10.2021 (çështja e themelit), Kolegji Penal është shprehur se nuk rezulton që kërkuesi të ketë argumentuar nëse nga gjykatat më të ulëta ka pasur zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural apo nëse vendimet e gjykatave më të ulëta bien në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Gjykatës së Lartë *(shih paragrafin 60 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë)*. Por, nga ana tjetër, Kolegji Penal në arsyetim ka vijuar se, pavarësisht kësaj, çmon se duhet t'u kthejë përgjigje disa prej pretendimeve të ngritura në rekurs, duke veçuar ato që meritojnë vëmendje të veçantë *(shih paragrafin 61 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë)*.

45. Gjykata vëren se pretendimi kryesor i kërkuesit ka qenë cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të dënimit pa ligj. Për këtë pretendim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar: *"Jurisprudenca e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka njohur dhe analizuar metodën e falsifikimit intelektual si një nga mënyrat e kryerjes së veprës penale të falsifikimit të dokumenteve të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Për falsifikimin intelektual Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 00-2017-581 i Vendimit (111), datë 12.7.2017, shprehet se: "...Falsifikimi intelektual kryhet me anë të krijimit tërësisht të aktit, dokumentit, me anë të të cilit një subjekt fizik apo juridik, publik ose privat, shpreh vullnet, merr përsipër të drejta dhe detyrime, të cilat realisht nuk i ka shprehur..."."...Vepra penale e falsifikimit të dokumenteve si njëra nga format e kryerjes e përmendur më sipër, mund të bëhet në dy mënyra: ose duke vepruar drejtpërsëdrejti mbi dokumentin, duke i bërë shtesa a tjetërsime të paligjshme, apo me çdo veprim tjetër material një dokumenti ekzistues të mëparshëm. Në këtë rast, do të ndodhemi përpara falsifikimit "material"; apo në mënyrën tjetër që konsiston në falsifikimin e përmbajtjes së dokumentit, pa prekur formën e tij, duke ndryshuar konceptin dhe brendinë e dokumentit. Në këtë rast, kemi të bëjmë me falsifikim "intelektual" që cenon pjesën përshkruese-dëftuese të dokumentit...". Rrjedhimisht, pretendimi i të gjykuarit se ai është i dënuar pa ligj nuk qëndron pasi ai nuk gjen mbështetje në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë. Gjykata e Lartë në praktikën e saj gjyqësore ka pranuar metodën e falsifikimit intelektual si një nga mënyrat e realizimit të veprës penale të falsifikimit të dokumentit të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal" (shih paragrafët 81 dhe 82 të vendimit nr. 00-2021-670 (63), datë 26.10.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë)*.

46. Nisur nga arsyetimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në çështjen konkrete, Gjykata duke mbajtur në konsideratë edhe rolin subsidiar të saj në respektimin në tërësi të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, e në rastin konkret të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të

lidhur me dënimin pa ligj (paragrafi i parë i nenit 29 të Kushtetutës), vlerëson se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk i plotëson standardet e vendosura për arsyetimin e vendimit gjyqësor. Arsyetimi i vendimit për pretendimin kryesor të kërkuesit, atë të dënimit pa ligj, nuk rezulton të jetë i qartë dhe i plotë. Kolegji Penal për këtë pretendim është mjaftuar me arsyetimin e mësipërm dhe duke u bazuar në argumente të lidhura me precedentin gjyqësor.

47. Ashtu sikundër u theksua me lart (*shih paragrafin 40 të këtij vendimi*), detyrimi për arsyetim ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë. Ndaj ky vlerësim i Gjykatës për pamjaftueshmërinë e arsyetimit merr më tepër rëndësi, nisur nga natyra e veçantë dhe kompleksiteti i çështjes konkrete. Detyrimi për arsyetim presupozon gjithsesi që një palë në proces mund të presë një përgjigje specifike dhe të shprehur për ato parashtrime që janë përcaktuese për përfundimin e procesit në fjalë, pra pretendimi kryesor për dënimin pa ligj duhej të kishte vëmendje të shtuar nga Kolegji Penal. Gjithashtu, Gjykata vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit, duke mos dhënë arsyet për mosshqyrtimin e saj në seancë gjyqësore dhe nuk ka argumentuar për pretendimin thelbësor të kërkuesit, që lidhet me funksionin kushtetues të Gjykatës së Lartë, sipas së cilit, ajo shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore.

48. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me dënimin pa ligj është i bazuar.

49. Për sa u takon pretendimeve të tjera, Gjykata vlerëson të mos ndalet në analizimin e tyre, për sa kohë çështja do të merret përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, e cila, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit dhe si kontrolluese e respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhet t'u japë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të ngritura në rekurs.

50. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit, sipas arsyetimit të mësipërm, janë të bazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri[1],

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2021-670 (63), datë 26.10.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 26.9.2022.
Shpallur më 28.10.2022.

Kryetare: Vitore Tusha
Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Altin Binaj, Sandër Beci

[1] Gjyqtarët Altin Binaj dhe Sandër Beci votuan vetëm për cenimin e parimit të paanshmërisë gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë.